



BQK publikoi statistikat për sektorin financiar për muajin nëntor 2014 dhe sektorin e jashtëm për tremujorin e tretë të vitit 2014

Kumtesë për shtyp
31 dhjetor 2014

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës publikoi statistikat e sektorit financiar me të dhënat për muajin nëntor 2014, si dhe statistikat e sektorit të jashtëm me të dhënat për tremujorin e tretë 2014. Të dhënat janë publikuar në kuadër të Serive Kohore në faqen e internetit të BQK-së, sipas kalendarit të publikimeve t+25 për sektorin financiar dhe t+90 për sektorin e jashtëm.

Statistikat e sektorit financiarë ndër të tjera përfshijnë pasqyrat e korporatave financiare, bilancin e gjendjes së BQK-së, bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit të bankave komerciale, vlerën e kredive dhe depozitave, normat e interesit për kredi dhe depozita, pasqyrat financiare të korporatave të tjera financiare, etj. Statistikat e sektorit të jashtëm përfshijnë statistikat e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare, statistikat e borxhit të jashtëm të Kosovës, remitencat, investimet e huaja direkte, investimet në letra me vlerë jashtë vendi, etj.

Statistikat e sektorit të jashtëm janë të publikuara sipas metodologjisë së re të rekomanduar me manualin *Bilanci i Pagesave dhe Pozicionit i Investimeve Ndërkombëtare (BPM6)*, botimi i gjashtë, i Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Të dhënat e publikuara janë në përputhje me standardet statistikore ndërkombëtare dhe ofrojnë një shkallë të lartë të krahasueshmërisë me ato të vendeve tjera. Këto informata njëkohësisht publikohen edhe në FMN në kuadër të publikimit “Statistikat Financiare Ndërkombëtare” (anglisht: International Financial Statistics – IFS) dhe në Bankë Botërore në kuadër të publikimit “Statistikave Tremujore të Borxhit të Jashtëm” (anglisht: Quarterly External Debt Statistics – QEDS).

Më poshtë është dhënë një pasqyrë e përmbledhur, që karakterizon statistikat e sektorit financiar për muajin nëntor 2014 dhe statistikat e sektorit të jashtëm për tremujorin e tretë 2014. Në fund është paraqitur edhe një shtojcë statistikore lidhur me komponentët kryesorë të statistikave të sektorit financiar dhe sektorit të jashtëm.

SEKTORI FINANCIAR

Bilanci i gjendjes i BQK-së

Më 30 nëntor 2014, gjithsej asetet e BQK-së ishin 1.48 miliardë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, asetet e BQK-së ishin më të ulëta për 180 milionë euro. Rënia e aseteve erdhi kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të depozitave në BQK të Fondit Pensional të Kosovës (për 97.4 milionë euro), Qeverisë qendrore (për 39.2 milionë euro), Agjencisë Kosovare të Privatizimit (për 30.9 milionë euro) dhe bankave komerciale (për 19.0 milionë euro).

Asetet e BQK-së të investuara jashtë vendi në formë të *depozitave* dhe *letrave me vlerë*, më 30 nëntor 2014 ishin 1.33 miliardë euro. Kjo vlerë është për 171.6 milionë euro më e ulët se në nëntor të vitit të kaluar. Investimet në letra me vlerë përbëjnë rreth 40 përqind të totalit të investimeve të BQK-së jashtë vendi.

Detyrimet e BQK-së janë kryesisht detyrime ndaj sektorit publik. Rreth 57 përqind e gjithsej detyrimeve janë depozitat nga ky sektor. Më 30 nëntor, depozitat nga sektori publik në BQK ishin 844.2 milionë euro, prej të cilave 541.3 i përkasin Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Një pjesë tjetër e rëndësishme e depozitave në BQK janë depozita nga bankat komerciale. Vlera e tyre në fund të nëntorit ishte 338.3 milionë euro. Kapitali i BQK-së më 30 nëntor 2014 ishte 51.8 milionë euro.

Bilanci i gjendjes së bankave komerciale

Asetet e bankave komerciale më 30 nëntor 2014 shënuan vlerën 3.16 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 179.7 milionë. *Kreditë bruto* shënuan vlerën 1.86 miliardë euro dhe ishin për 57.6 milionë më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, *investimet e bankave komerciale jashtë vendi* ishin më të ulëta për 51.1 milionë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe shënuan vlerën 586.5 milionë euro.

Më 30 nëntor 2014, *depozitat e klientëve* në bankat komerciale ishin 2.50 miliardë euro (2.36 miliardë euro në nëntor 2013). Raporti i *kredive* ndaj *depozitave* mbetet në nivelin 74.3 përqind. Rreth 33.7 përqind e depozitave janë depozita të afatizuara. *Huamarrjet e bankave, provizionet për kredi dhe detyrimet e tjera* - të gjitha së bashku kanë shënuar rënie për 18 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kapitali i bankave komerciale në fund të nëntorit ishte 317 milionë euro duke shënuar një rritje vjetore prej 15.4 përqind. *Fitimi neto* i bankave komerciale deri në fund të muajit nëntor 2014 shënoi vlerën 54 milionë euro (23.6 milion euro ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).


Normat e interesit në kredi dhe depozita

Norma mesatare e interesit në depozita për muajin nëntor 2014 ishte 0.6 përqind (3.2 përqind ishte në nëntor 2013). Rënia e normës së interesit në depozita ishte më e theksuar për ekonomitë familjare sesa për korporatat jofinanciare.

Norma e interesit në kredi e aplikuar nga bankat komerciale gjatë muajit nëntor ishte 9.9 përqind (12.2 ishte në nëntor 2013) dhe paraqet vlerën më të vogël të normës së interesit që prej fillimit të publikimit të serive kohore. Diferenca e normës së interesit në mes të kredive dhe depozitave ishte 9.3 përqind (8.9 përqind ishte në nëntor 2013).

Norma mesatare e interesit në kredi e aplikuar nga institucionet mikrofinanciare gjatë muajit nëntor 2014 ishte 22.7 përqind (22.5 ishte në nëntor 2013). Pjesëmarrja e kredive të reja të ekonomive familjare për muajin nëntor 2014 ishte 65 përqind.

Figura 1 . Norma e interesit në kredi dhe depozita




¹ Normat e interesit në kredi nga institucionet mikrofinanciare kanë filluar të përpilohen për herë të parë nga janari 2012

SEKTORI I JASHTËM

Bilanci i pagesave të Kosovës

Në tremujorin e tretë të vitit 2014 deficitin e llogarisë rrjedhëse ishte 91.8 milionë euro, që paraqet një rënie prej 7.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2013. Përveç llogarisë së mallrave, e cila në vazhdimësi ndikon në rritjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse, të tre komponentët e tjerë të llogarisë rrjedhëse kanë ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e deficitit. Deficiti i llogarisë së mallrave shënoi vlerën 582.4 milionë euro dhe shprehur në terma relativ ishte 5.5 përqind më i lartë se në tremujorin e tretë të 2013. Llogaria e shërbimeve vazhdon të shënoi bilanc pozitiv, vlera e së cilës në tremujorin e tretë 2014 arriti 137.9 milionë euro (124.1 milionë euro në TM3 2014). Të ardhurat parësore në tremujorin e dytë 2014 shënuan vlerën 19.8 milionë euro dhe kjo vlerë është për 17.8 milionë euro më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Llogaria e të ardhurave dytësore mbetet kontribuuesi kryesor në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në tremujorin e tretë 2014, llogaria e të ardhurave dytësore shënoi vlerën 332.9 milionë euro, që paraqet një rritje prej 2.1 përqind nga tremujori i tretë i vitit 2013. Remitencat në Kosovë në tremujorin e tretë 2014 ishin 214 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 9.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 2. Deficiti i llogarisë rrjedhëse, në milion euro




Bilanci i investimeve të huaja direkte (IHD) në Kosovë në tremujorin e tretë të vitit 2014 ka arritur vlerën 82.6 milionë euro dhe paraqet një rritje prej 17.1 përqind krahasuar me tremujorin e tretë 2013. Bilanci i investimeve në letra me vlerë, pa përfshirë letrat me vlerë në kuadër të aseteve rezervë, gjatë këtij tremujori është 59.3 milionë euro (91.8 milionë euro ishte në tremujorin e tretë 2013). Në anën tjetër, pozicioni i rezervave ndërkombëtare në tremujorin e tretë 2014 është rritur për 51.7 milionë euro.

Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

Kosova vazhdon të regjistrojë bilanc pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) i cili në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014 arriti vlerën prej 396.7 milionë euro (327.8 milionë euro ishte në fund të tremujorit paraprak). Krahasuar me tremujorin paraprak, asetet e jashtme kanë shënuar rritje për 184.2 milionë duke shënuar vlerën 4.29 miliardë euro. Kontribuuesit kryesor të rritjes së asetëve të jashtme kanë qenë kategoria e *investimeve portofolio* e cila kishte një rritje prej 73.1 milionë euro dhe kategoria e *asetëve rezervë* e cila gjithashtu kishte një rritje në vlerë prej 53.7 milionë euro. Në anën tjetër edhe detyrimet ndërkombëtare kanë shënuar rritje në vlerë prej 115.4 milionë euro të cilat kanë shënuar vlerën 3.90 miliardë euro në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014. Rritjes së detyrimeve të huaja më së shumti i ka kontribuar rritja e *investimeve të huaja direkte në Kosovë* (rreth 84.8 milionë euro) dhe *investimeve të tjera* (rreth 30.6 milionë euro).


Figura 3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare, gjendja në fund të periudhës në miliardë euro



Borxhi i jashtëm i Kosovës

Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës, i cili përfshin borxhin publik dhe borxhin privat, në fund të shtatorit 2014 shënoi vlerën 1.69 miliardë euro. Borxhi publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm (rreth 23 përqind), gjendja e të cilit në fund të shtatorit ishte 383.4 milionë euro. Pjesa më e madhe e borxhit publik përbëhet nga borxhi i jashtëm i Qeverisë, i cili në fund të shtatorit 2014 ishte 318.1 milionë euro.

Figura 4. Borxhi i jashtëm bruto, gjendja në fund të periudhës në miliardë euro²



Borxhi i sektorit privat në fund të muajit shtator 2014 shënoi vlerën prej 1,306.6 milionë euro. Pjesa më e madhe e borxhit privat është në formë të kredive ndërmjet kompanive, që janë në relacion të investimeve direkte (711.1 milionë euro), pasuar nga sektorët e tjerë të ekonomisë (383.8 milionë euro) dhe huamarrjet e bankave komerciale (211.8 milionë euro). Në kuadër të sektorëve tjerë bëjnë pjesë institucionet financiare jobankare, korporatat jofinanciare, organizatat joqeveritare dhe ekonomitë familjare. Në këtë kategori, dominojnë kreditë tregtare të korporatave jofinanciare që importojnë mallra (180.1 milionë euro).

² Në kuadër të borxhit publik është përfshirë edhe alokimi i SDR-ve nga FMN-ja, konform standardeve ndërkombëtare.

Shtojca statistikore

Tabela 1. Bilanci i gjendjes i BQK-së
(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2013		2014											
	Nen	Dhj	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	
ASETET														
DST-të	60.2	59.6	60.3	59.5	59.5	59.5	59.8	59.9	60.4	60.6	61.6	61.5	61.4	
Paraja e gatshme	29.5	27.4	42.9	26.5	28.8	32.7	20.2	33.0	18.4	36.7	30.9	34.8	18.4	
Depozitat	1,076.0	890.9	842.4	860.6	828.7	799.4	807.1	828.6	890.6	1,000.3	942.0	966.7	945.4	
Depozitat e transferueshme	18.9	55.8	48.5	4.8	2.5	5.7	24.4	126.6	143.6	176.0	136.0	175.7	157.2	
Depozitat tjera (të afatizuara dhe në llogari të kursimeve)	1,057.1	835.1	793.9	855.7	826.2	793.7	782.7	702.0	747.0	824.3	806.0	791.0	788.2	
Letrat me vlerë përveç aksioneve	421.0	560.8	660.8	630.9	630.9	645.9	630.9	560.9	400.9	336.0	326.0	330.0	380.0	
Llogaritë tjera të arkëtueshme	1.1	1.6	1.2	0.3	1.1	1.2	0.7	1.5	1.3	0.5	1.1	1.1	0.3	
Kuota në FMN	66.6	65.9	66.7	66.1	66.2	66.2	66.8	66.9	67.5	68.0	69.1	69.0	69.3	
Asetet jofinanciare	3.2	3.2	3.2	3.2	3.2	3.3	3.3	3.3	3.3	3.3	3.3	3.3	3.2	
Asete gjithsej	1,657.6	1,609.4	1,677.6	1,647.0	1,618.5	1,608.2	1,588.7	1,554.1	1,442.5	1,505.4	1,433.9	1,466.3	1,478.0	
DETYRIMET DHE KAPITALI														
KTD-të (Bankat)	357.3	327.8	323.0	293.4	255.7	245.1	228.7	242.9	250.7	299.8	291.2	300.5	338.3	
Kompanitë e sigurimeve & Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve	4.7	5.0	5.0	4.8	5.0	5.0	5.0	4.8	4.2	4.0	4.8	4.1	3.9	
Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës	22.7	22.7	23.2	23.2	23.2	23.8	23.8	23.8	24.3	24.3	24.2	24.8	24.7	
Sektori publik	1,022.4	1,007.6	1,079.8	1,083.0	1,091.0	1,091.1	1,090.1	1,039.2	919.6	935.8	844.0	867.5	844.2	
Agjencia Kosovare e Privatizimit	572.2	550.3	552.9	553.4	544.5	545.9	545.8	544.8	539.9	541.7	540.7	543.3	541.3	
Fondi Pensional i Kosovës	138.5	209.7	202.1	215.9	225.6	235.1	258.1	181.2	84.8	84.6	10.0	36.3	41.1	
Korporatat publike jofinanciare	24.7	24.6	53.4	56.5	55.4	51.9	45.8	47.9	47.1	46.9	21.8	8.5	13.4	
Kuota në FMN (25% e kuotës)	16.3	16.1	16.3	16.2	16.2	16.2	16.3	16.4	16.5	16.6	16.9	16.9	16.9	
Depozitët e Qeverisë qendrore	270.7	206.8	255.1	241.1	249.2	242.0	224.1	248.9	231.4	245.9	254.5	262.5	231.5	
Alokimi i DST-ve	62.5	61.9	62.6	62.0	62.1	62.1	62.7	62.8	63.3	63.8	64.8	64.7	65.0	
Llogaria me FMN	161.0	155.8	155.8	153.2	153.6	153.6	150.8	152.6	152.6	149.9	152.5	152.5	149.7	
Llogaria e pagueshme	0.3	0.8	0.4	0.2	0.1	0.4	0.3	0.5	0.4	0.3	0.2	0.4	0.2	
Kapitali dhe të ngjajshme	49.4	50.5	51.0	50.4	51.0	50.8	51.2	51.4	51.6	51.8	52.2	51.8	51.8	
Fitimi / humbja gjatë vitit	-0.8	0.2	0.5	-0.1	0.6	0.4	0.8	1.0	1.2	1.4	1.8	1.4	1.4	
Detyrimet dhe kapitali gjithsej	1,657.6	1,609.4	1,677.6	1,647.0	1,618.5	1,608.2	1,588.7	1,554.1	1,442.5	1,505.4	1,433.9	1,466.3	1,478.0	

Tabela 2. Bilanci i gjendjes i bankave komerciale

(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2013		2014										
	Nën	Dhj	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Sht	Tet	Nën
ASETET													
Paraja e gatshme	111.7	130.6	109.0	104.6	112.0	112.7	109.9	115.3	140.4	123.2	121.7	113.5	105.7
Bilanci me BQK	356.8	332.8	322.7	293.4	255.7	244.7	228.7	242.8	250.7	299.8	291.2	300.5	338.3
Bilanci me Bankat komerciale	332.0	339.9	383.6	397.2	384.8	355.5	360.8	318.7	377.2	380.9	385.5	417.6	379.9
Letrat me vlerë	278.1	354.5	355.1	373.2	392.7	397.4	397.4	405.3	380.9	418.9	410.0	380.6	379.5
Kreditë bruto	1,803.2	1,805.8	1,794.5	1,794.3	1,825.9	1,839.7	1,856.8	1,889.9	1,874.3	1,848.2	1,855.0	1,854.0	1,860.8
Asete tjera	95.1	95.8	83.7	82.5	82.3	88.3	87.5	87.4	92.8	89.5	86.0	84.1	92.3
Asete gjithsej	2,976.7	3,059.3	3,048.5	3,045.1	3,053.3	3,038.3	3,041.0	3,059.5	3,116.4	3,160.4	3,149.5	3,150.3	3,156.4
DETYRIMET DHE KAPITALI													
DETYRIMET													
Bilanci nga bankat komerciale	15.1	16.5	21.3	21.3	21.6	23.1	25.7	29.9	26.9	25.3	22.2	22.5	27.2
Depozitat:	2,359.2	2,449.0	2,443.4	2,433.4	2,430.8	2,425.9	2,415.1	2,421.0	2,474.9	2,513.6	2,518.0	2,514.0	2,502.7
Transferueshme	833.1	900.8	887.4	890.7	910.4	920.0	926.7	957.8	1,029.1	1,096.6	1,100.3	1,112.3	1,129.9
Kursimit	390.5	404.2	421.7	428.8	435.0	443.0	453.2	456.6	469.9	494.2	508.8	521.6	528.4
Afatizuara	1,135.5	1,144.0	1,134.4	1,113.8	1,085.4	1,062.9	1,035.1	1,006.6	975.9	922.8	908.8	880.1	844.4
Humarjet tjera	66.9	69.8	69.6	70.2	69.7	70.9	71.8	75.3	74.4	74.0	64.2	64.3	63.7
Detyrimet tjera	89.6	74.7	60.1	61.8	65.6	61.7	66.0	65.2	61.0	61.8	59.4	57.3	66.1
Provizionet për kredi	171.2	171.5	173.4	175.2	177.9	181.2	180.0	178.2	179.5	177.0	175.7	179.5	179.6
KAPITALI	274.7	277.8	280.8	283.2	287.6	275.5	282.5	289.9	299.6	308.8	310.0	312.7	317.0
Fitimi/humbja e vitit	23.6	25.9	2.9	5.4	9.8	12.5	19.4	26.9	31.5	40.7	46.9	49.6	54.0
Kapitali vetanak, rezervat & tjera	251.1	251.9	277.9	277.8	277.8	263.0	263.1	263.1	268.1	268.1	263.1	263.1	263.0
Detyrimet dhe kapitali gjithsej	2,976.7	3,059.3	3,048.6	3,045.1	3,053.3	3,038.3	3,041.0	3,059.5	3,116.4	3,160.4	3,149.5	3,150.3	3,156.4

Tabela 3. Normat e Interesit për Kredi dhe Depozita
(Në përqindje)

Përshkrimi	2013		2014										
	Nën	Dhj	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gush	Sht	Tet	Nën
DEPOZITAT													
Korporatat jofinanciare	3.00	1.16	2.56	1.14	0.49	0.29	0.52	0.25	0.15	0.70	0.37	0.44	0.70
Ekonomitë familjare	3.22	2.81	2.69	2.08	1.67	0.62	0.61	0.59	0.72	0.89	1.00	0.52	0.55
Mesatarja e ponderuar	3.22	2.39	2.69	2.04	1.66	0.60	0.60	0.59	0.67	0.89	0.99	0.51	0.56
KREDITË													
Korporatat jofinanciare	12.15	10.95	11.82	11.91	11.27	10.55	10.33	10.50	10.67	10.68	10.74	10.49	10.18
Ekonomitë familjare	12.26	11.45	11.60	11.69	11.10	11.07	10.68	10.84	10.84	10.85	10.77	10.29	9.68
Linjat kreditore-korporatat jofinanciare	11.94	11.03	12.86	10.99	10.94	11.00	11.96	11.31	10.65	10.20	9.09	9.36	8.94
Mbitërheqjet -korporatat jofinanciare	9.44	9.36	8.80	8.82	9.85	9.42	9.85	9.43	9.59	9.46	11.20	10.96	11.89
Mbitërheqjet -ekonomitë familjare	15.93	14.41	14.58	13.77	14.62	14.04	11.78	14.26	13.62	13.43	13.43	13.84	13.32
Mesatarja e ponderuar	12.19	11.07	11.73	11.81	11.20	10.74	10.45	10.63	10.76	10.75	10.75	10.40	9.88
Institucionet mikrofinanciare													
KREDITË													
Korporatat jofinanciare	20.05	19.81	21.41	15.98	18.36	20.75	18.87	24.60	17.71	17.09	21.34	20.48	17.66
Ekonomitë familjare	22.86	23.74	25.17	24.11	24.48	24.20	25.51	25.28	24.75	24.41	23.82	24.59	24.03
Mesatarja e ponderuar	22.51	22.65	24.75	23.32	24.06	23.81	23.17	25.21	22.72	23.19	23.38	23.42	22.71

Tabela 4. Bilanci i pagesave

(Në milionë euro)

Përshkrimi	2012				2013				2014		
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3
Llogaria rrjedhëse	-20.9	-120.9	-143.5	-94.9	-13.4	-117.5	-99.7	-108.8	-38.8	-160.2	-91.8
Mallrat	-369.4	-543.0	-605.5	-532.2	-390.7	-518.6	-551.9	-534.3	-391.5	-540.4	-582.4
Eksporti (f.o.b.)	60.4	77.2	70.9	73.4	68.5	80.8	72.0	70.2	65.8	73.9	95.7
Importi (f.o.b.)	429.7	620.2	676.4	605.6	459.2	599.4	623.9	604.5	457.3	614.4	678.1
Shërbimet	43.8	75.9	122.8	81.3	60.6	79.7	124.1	47.8	62.7	76.5	137.9
Eksporti	109.2	148.6	228.5	155.2	107.6	149.5	240.4	135.0	126.6	165.1	287.8
Importi	65.4	72.7	105.6	73.9	47.0	69.8	116.3	87.2	63.8	88.6	149.9
Të ardhurat parësore	37.4	43.9	20.3	51.9	42.4	32.5	2.1	44.6	31.4	31.4	19.8
Kredi	59.3	57.9	56.4	56.4	57.3	55.4	55.3	59.5	49.6	53.2	58.5
Debi	21.9	13.9	36.1	4.5	14.9	22.9	53.3	15.0	18.2	21.8	38.7
Të ardhurat dytësore	267.2	302.3	318.9	304.1	274.3	288.9	326.0	333.2	259.7	272.3	332.9
Kredi	293.5	328.2	345.2	329.5	294.4	309.4	346.6	353.6	278.6	291.4	361.0
prej të cilave: Remitancat	119.1	142.4	174.7	168.9	127.8	144.6	182.2	166.2	130.8	160.5	214.4
Debi	26.3	25.9	26.4	25.4	20.0	20.4	20.6	20.5	18.9	19.1	28.2
Llogaria kapitale	-0.9	2.5	-1.7	13.0	10.6	3.1	9.7	11.4	3.4	-2.6	4.6
Kredit	2.8	7.2	2.9	18.8	10.1	7.0	7.3	16.6	7.2	0.0	7.4
Debit	3.7	4.7	4.5	5.8	-0.5	3.9	-2.4	5.2	3.8	2.6	2.8
Llogaria financiare	-13.8	-86.4	25.9	-66.7	10.1	-138.1	58.1	-62.2	25.8	-111.9	78.8
Investimet direkte	-55.0	-23.5	-88.5	-46.3	-57.3	-83.8	-56.8	-52.4	-37.3	-0.2	-67.2
Asetet	1.7	6.4	3.7	3.9	3.1	5.0	13.8	8.2	5.2	-3.8	15.5
Detyrimet	56.7	29.9	92.3	50.2	60.3	88.7	70.6	60.6	42.5	-3.6	82.6
Investimet në letrat me vlerë	81.0	-37.0	163.2	-21.5	53.5	81.7	91.8	-87.7	50.2	3.1	59.3
Asetet	81.0	-37.0	163.2	-21.5	53.5	81.7	91.8	-87.7	50.2	3.2	59.3
Detyrimet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investimet e tjera	-47.8	-36.9	-255.0	-35.1	20.1	-150.6	-46.2	191.1	19.0	-93.2	35.0
Asetet	-112.8	27.5	-107.7	46.7	-39.1	-106.1	33.1	195.6	2.7	-49.5	42.6
Detyrimet	-65.0	64.4	147.3	81.8	-59.2	44.5	79.3	4.5	-16.2	43.7	7.7
Asetet rezervë	8.0	11.1	206.2	36.2	-6.3	14.6	69.3	-113.3	-6.2	-21.7	51.7
Gabimet dhe harresat	8.0	32.0	171.1	15.1	12.9	-23.8	148.1	35.3	61.2	50.8	166.0

Tabela 5. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare
(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2012				2013				2014		
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3
PIN Neto	206.5	319.3	237.7	248.8	416.8	276.2	414.9	363.7	394.3	327.8	396.7
Asetet	3344.2	3351.7	3634.0	3705.1	3857.2	3846.9	4076.4	4102.6	4161.8	4115.2	4299.5
Investimet direkte	103.8	110.2	113.9	117.8	120.9	125.2	139.6	147.5	152.7	148.9	164.4
Investimet portfolio	860.6	814.5	998.7	986.6	1073.1	1138.1	1253.9	1192.6	1252.4	1280.8	1354.0
Në kapital dhe në aksione në fonde investive	580.9	598.7	621.9	666.3	734.3	777.6	816.6	650.8	660.4	752.4	967.4
Në letra me vlerë të borxhit	279.8	215.9	376.8	320.3	338.8	360.5	437.3	541.7	592.0	528.4	386.6
Derivatvët financiarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Investimet tjera	1798.9	1826.1	1715.6	1760.6	1829.8	1737.3	1768.9	1963.2	1963.6	1913.6	1955.6
Ekuitete të tjetër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Paraja e gatshme & depozita	1734.9	1762.0	1633.3	1673.9	1721.3	1631.8	1655.9	1833.6	1823.0	1775.9	1852.5
Kreditë	59.0	58.2	79.1	81.3	94.4	84.5	96.6	112.0	124.0	119.5	86.7
Kreditë tregtare dhe avanset	1.0	1.0	1.0	1.2	11.0	16.8	13.9	13.7	12.1	12.8	13.8
Llogaritë e tjera të pranueshme	4.1	4.9	2.1	4.3	3.1	4.3	2.5	4.0	4.5	5.4	1.7
Asetet rezervë	580.9	600.9	805.8	840.0	833.4	846.2	913.9	799.3	793.1	771.8	825.5
Detyrimet	3137.7	3032.4	3396.2	3456.3	3440.4	3570.7	3661.5	3738.8	3767.5	3787.4	3902.8
Investimet direkte	2369.4	2385.0	2471.5	2524.3	2582.4	2669.4	2739.9	2816.4	2859.7	2838.1	2923.0
Investimet portfolio	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Në kapital dhe në aksione në fonde investive	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Në letra me vlerë të borxhit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Derivatvët financiarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Investime të tjera	768.3	647.4	924.8	931.9	858.0	901.3	921.6	922.4	907.8	949.2	979.8
Ekuitete tjera	1.3	0.7	0.7	0.5	1.8	0.7	0.8	0.7	0.8	0.8	0.9
Paraja e gatshme dhe depozitat	112.4	107.7	115.4	120.9	130.6	110.6	129.2	123.8	136.9	126.6	127.6
Kreditë	471.2	472.2	515.5	541.3	537.4	564.9	561.6	579.6	582.0	599.7	602.0
Kreditë tregtare dhe avanset	115.8	167.3	219.6	199.8	119.4	156.5	162.9	154.3	121.1	155.5	156.5
Të drejtat speciale të tërheqjes – DST	64.2	66.7	66.0	64.6	64.8	63.7	62.9	61.9	62.1	62.7	65.2

Tabela 6. Borxhi i jashtëm

(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2012				2013				2014		
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3
Borxhi Publik dhe Borxhi Publik i Garantuar	312.7	321.0	361.2	401.4	398.0	394.8	387.8	383.9	379.7	381.8	383.4
Qeveria e Përgjithshme	247.4	253.5	294.2	336.5	332.8	331.1	324.6	321.8	317.5	318.9	318.1
Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Afatgjatë	247.4	253.5	294.2	336.5	332.8	331.1	324.6	321.8	317.5	318.9	318.1
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	65.3	67.5	66.9	65.0	65.1	63.8	63.2	62.1	62.2	62.9	65.4
Afatshkurtër	1.1	0.7	0.9	0.4	0.3	0.1	0.3	0.3	0.1	0.2	0.1
Afatgjatë	64.2	66.7	66.0	64.6	64.8	63.7	62.9	61.9	62.1	62.7	65.2
Borxhi i Sektorit Privat i Pagarantuar	1,027.9	915.9	1,172.1	1,115.9	1,054.9	1,146.1	1,197.0	1,224.3	1,214.0	1,264.4	1,306.6
Korporata Depozituese, me përjashtim të Bankës Qendrore	189.4	176.0	184.1	175.6	185.8	184.3	206.8	208.1	225.2	229.3	211.8
Afatshkurtër	189.4	176.0	184.1	175.6	185.8	184.3	206.8	208.1	225.2	229.3	211.8
Afatgjatë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sektorët tjerë	264.9	149.8	378.9	354.4	272.5	321.4	326.2	329.7	302.1	337.3	383.8
Afatshkurtër	222.0	110.9	340.6	321.0	238.3	277.1	278.4	281.1	247.5	281.4	312.6
Afatgjatë	42.9	38.8	38.3	33.5	34.2	44.3	47.7	48.5	54.6	55.9	71.2
Investimet Direkte: Kreditimi ndërmjet kompanive	573.6	590.1	609.1	585.9	596.7	640.4	664.0	686.5	686.7	697.8	711.1
Gjithsej Borxhi i Jashtëm Bruto	1,340.6	1,236.8	1,533.2	1,517.3	1,452.9	1,541.0	1,584.8	1,608.2	1,593.7	1,646.2	1,690.0